



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS

KI Z

Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë

VENDIM

Nr.2 Datë 6.02.2019

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË UT, PËRFAQËSUES TË MASR, KRITERET, DOKUMENTACIONI DHE AFATET E DORËZIMIT TË TYRE

Në mbështetje të VKM-së nr.782, datë 26.12.2018 "*Për caktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të Ministrisë përgjegjëse për Arsimin, në institucionet publike të Arsimit të Lartë*", si dhe të shkresës nr.322 Prot., datë 14.1.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.782, datë 26.12.2018, më lart përmendur; në Ligjin nr.80/2015 datë 22.05.2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë*"; në Rregulloren nr. 2459/1 prot., datë 15.3.2016, të Ministres së Arsimit dhe Sporteve "*Për organizimin e zgjedhjeve të para për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", KIZ, në mbledhjen e tij të datës 06.02.2019,

VENDOSI:

1. Hapjen e procedurave për zgjedhjen e anëtarëve, përfaqësues të Ministrisë përgjegjëse për Arsimin në Bordin e Administrimit të Universitetit të Tiranës, të cilët, do të përzgjidhen nëpërmjet kandidaturave të votuara nga studentët e Universitetit të Tiranës, duke përzgjedhur 3(tri) kandidaturat më të votuara nga studentët, për emërim nga Ministri të njërës nga kandidaturat.
2. Proçesi i pranimit të aplikimeve fillon **nga data 7 deri më datën 11 Shkurt 2019**, pranë sekretarisë së KIZ.
3. Proçesi zgjedhor do të realizohet **në datën 25 Shkurt 2019**.
4. Kandidaturat që vetkandidojnë, duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:
 - a) Të jetë ekspert i njohur nga fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike e juridike.
 - b) Të ketë integritet etik dhe profesional.
 - c) Të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake.
 - d) Të mos jetë i dënuar penalisht, me vendim gjyqësor të formës së prerë.
 - e) Të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore për parandalimin e konfliktit të interesave.
5. Kandidati duhet të paraqesë:

- Shprehjen e vullnetit për kandidim,
- Kërkesën për kandidim, e cila duhet të përmbajë, emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, gjininë
- CV
- Deklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale.
- Deklarim se nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit nr.138/ 2015 “ Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike“ dhe ligjit nr.54/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë“.
- Vetëdeklarim që nuk është i angazhuar në funksione drejtuese partiake dhe që nuk ka konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore për parandalimin e konfliktit të interesave.
- Kopje të dokumentit të identifikimit
- Kopje të noteruar të diplomës universitare apo të cdo diplome tjetër që mund të ketë.
- Dokumentin që vërteton vendin ku kandidati është i punësuar.

6.Pas dorëzimit të dokumentacionit, cdo kandidati i jepet vërtetimi i regjistrimit si kandidat nga KIZ.

7. Kompetencat e funksionit që do të mbulojë anëtari i BA, janë të përcaktuara në nenin 49, të Ligjit Nr. 80/2015 “ Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë“.

8. Pas verifikimit të dokumentacionit, KIZ, jo më vonë se 48 orë nga përfundimi i afatit të paraqitjes së kërkesave për kandidim, miraton listën e kandidatëve. Listat shpallen publikisht në faqen zyrtare të UT dhe i përcillet të gjitha KZF dhe kandidatëve që vetkandidojnë.

9. Ky njoftim do të publikohet në faqen zyrtare të Universitetit të Tiranës.

10. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE TË UT

1. Dr.Majlinda Keta
2. Prof.Asoc.Dr.Bernard Dosti
3. Prof.Asoc.Dr.Oriona Muçollari
4. Gledjan Caka

Kryetar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Funksionet e Bordit të Administrimit në institucionet e arsimit të lartë

1. Bordi i Administrimit ka këto funksione kryesore:

- a) garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit të arsimit të lartë dhe përmbushjen e misionit të tij;
- b) me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij;
- c) me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;
- ç) me propozim të Senatit Akademik, miraton numrin e personelit në të gjitha nivelet;
- d) vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjetër të arsimit të lartë;
- dh) miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësisve përbërëse të institucionit të arsimit të lartë;
- e) jep mendim për projektregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;
- ë) përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;
- f) është përgjegjës për caktimin e kriterëve e të procedurave për punësimin e administratorëve dhe personelit administrativ, mbështetur në aktet e institucionit të arsimit të lartë;
- g) emëron dhe shkarkon administratorin e institucionit;
- gj) miraton paraprakisht statutin e institucionit të arsimit të lartë, para se t'i përcillet Senatit Akademik;
- h) miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga rektorati.

2. Në institucionet publike të arsimit të lartë vendimet e Bordit të Administrimit, për përcaktimin e bërë në shkronjën “gj”, të pikës 1, të këtij neni, merren me jo më pak se tre të pestën e votave të anëtarëve.

3. Kompetencat për ushtrimin e funksioneve të parashikuara në shkronjat “b”, “c”, “ç”, “d” dhe “dh”, të pikës 1, të këtij neni, në institucionet jopublike të arsimit të lartë, përcaktohen në statutet e tyre.

4. Funksione të tjera të Bordit të Administrimit përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë.